



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Lot III



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA

KOMUNA E ORAHOVACIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Direktoratë za Opštu Upravu

Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit

Uprava za urbanizam, planiranje i zashtitu okoline  
Department for Urbanism, planning and environmental protection

RAHOVEC - ORAHOVAC

Nr. I prot. 1537 Më 12.05.2020  
Dl. 2020

Data: 12.03.2020

Numri i vrojtimit i lejes: 12

Spektori për urbanizëm ,planifikim dhe mbrojtje mjedisit ,duke shqyrtuar kërkesën e Drejtoris se Sherbimeve Publike pran K. Rahovec me nr.12 Nr. 350/02-0027281/19-161 të datës 17.01.2020 për projektin "Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë -Rahovec" në kom. Rahovecit, Drejtoria e Urbanizmit , Planifikim dhe Mbrojtje Mjedisit k. Rahovec , për lëshimin e lejes ndërtimore për Auto rruga Rahovec -Xërxë (projekt investiv k. Rahovec; Memorandumi i mirkuptimit për financim e projekteve infrastrukturore në komunën e Rahovecit), në pronë pasuri shtetore kk Rahovec - rrugët , në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 , Rregullores komunale mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive me 01 nr. 109 të datës 14.07.2006 , dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 02/L-28, neni 11, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, Drejtoria e Urbanizmit,planifikim dhe mbrojtje e mjedisit lëshon këtë :

## VENDIM

(për Leje Ndërtimore)

### Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:

|           |                                             |         |  |
|-----------|---------------------------------------------|---------|--|
| Emri:     | Drejtoria e Sherbimeve Publike Kom. Rahovec |         |  |
| Adresa:   | Rr. Deshmoret e Pashtrikut pn               |         |  |
| Telefoni: | --                                          | Emaili: |  |

|                      |                                                                                 |         |  |
|----------------------|---------------------------------------------------------------------------------|---------|--|
| Emri iProjektit:     | Rregullimi i rrugës Auto rruga Rahovec – Xërxë                                  |         |  |
| Emri i Projektuesit: | Proing& Partners sh.p.k. (Mentor Lekaj bach.ing dhe Shaban Idrizi ing.dip.inf.) |         |  |
| Adresa:              | Prishtinë , kodra e diellit, Major M Bushi 12/11 perendimi                      |         |  |
| Telefoni:            | -                                                                               | Emaili: |  |

### Për punët ndërtimore në vijim:

|                                      |                             |                  |
|--------------------------------------|-----------------------------|------------------|
| Adresa e ndertimit : Rahovec - Xërxë |                             |                  |
| Zona(t) Kadastrale:                  | Nr. i parcelave kadastrale: | GPS Koordinatat: |
| Rahovec, Fortesë, Xërxë              | rrugët                      |                  |

### Lloji i ndërtimit të propozuar:

|                                                                                            |                                                                                                               |                                 |                                  |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|----------------------------------|
| Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>                                           | Rindërtim <input type="checkbox"/>                                                                            | Rrënim <input type="checkbox"/> | Riparim <input type="checkbox"/> |
| Kategoria e ndërtimeve të propozuara:                                                      |                                                                                                               |                                 |                                  |
| Kategoria I <input type="checkbox"/>                                                       | Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>                                                              |                                 |                                  |
| Përdorimi i propozuar rruga                                                                | A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> |                                 |                                  |
| Përshkrimi: Auto rruga Rahovec - Xërxë, ( titulli: Ndertimi i auto rrugës Rahovec - Xërxë) |                                                                                                               |                                 |                                  |

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Drejtoria e Sherbimeve Publike** i lejohet ndërtimi i **“Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec”**

**Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të **“APROVUAR”** nga organi kompetent;
  - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat të realizimit të ndërtimit;
  - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - kartelën e inspektimeve të miratuara, të vendosur në vend të dukshëm dhe e ruajtur nga dëmtimi nga moti sepse është i domosdoshëm kur investuesi të aplikojë për certifikatë të përdorimit;
  - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent mbi synimin për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
  - Të kontaktojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
  - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## A r s y e t i m

Aplikuesi **Drejtoria e Sherbimeve Publike** ka kërkuar nga organi kompetent **Drejtoria e Urbanizmit....** lëshimin e Lejes Ndërtimore për objektin e për ndërtimin e rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec, sipas projektit **“Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec”** me projektues **Proing& Partners sh.p.k.** ( Mentor Lekaj bach.ing dhe Shaban Idrizi ing.dip.inf.) . Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, Memorandumi i mirkuptimit për financim e projekteve infrastrukturore në komunën e Rahovecit, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e **Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Projekti i Autoudhes, **Rahovec - Xërxë** (projektues **Proing & Partners sh.p.k** (Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec) gushtë 2019
- Memorandumi i mirkuptimit për financim e projekteve infrastrukturore në komunën e Rahovecit
- Kërkesa

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Arhivit urbanizmit



Drejtori

Rumir Zhuniqu